



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.168/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit LDK-AKR, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje(LVV),me seli ne Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterev në objektin publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 10.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.168/2017 e datës 10.06.2017, nga koalicioni LDK-AKR, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga koalicioni LDK-AKR, me seli Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 07.06.2017, kanë vërejtur se ne rrugët e Prishtinës konkretisht në stacionin e autobusëve në Prishtinë janë vendosur postere dhe bilborde të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se nga ana e subjektit politik , është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në përgjigjen në ankesë të datës 08.06.2017, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje thekson se Lëvizja Vetëvendosje ka marrëveshje kontraktuese me “Selmans Network” , kompani që ka në menaxhim hapësirat reklamues të stacioneve për shfrytëzimin e këtyre hapësirave te marketingut dhe si dëshmi është parashtruar marrëveshja e lidhur me datën 20.06.2017. Andaj ka propozuar që ankesa e parashtruar të hedhë poshtë si te palejuar. Përgjigjes në ankesë ju ka bashkangjitur marrëveshjen e lidhur ndërmjet tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj të ankesës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë, se nga ana subjektivit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk është bërë shkelja e nenit 33 pika (b) të LZP-së, të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektivit politik Lëvizja Vetëvendosje, nuk është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret nga subjekti në fjalë, janë vendosur në objektin publike të kontraktuar ndërmjet palëve dhe kjo është argumentuar me marrëveshjen e lidhur ndërmjet subjektivit politik (LVV) dhe kompanisë “Selmans Network SHPK” në Prishtinë, nga ana e përfaqësuesve të subjektivit politik dhe kompanisë së kontraktuar. Palët ishin pajtuar se kompania është e obliguar që të vene në dispozicion hapësirat reklamuese për subjektin në fjalë për fushatën zgjedhore, me kohëzgjatje të shfrytëzimit të hapësirave të kontraktuar prej datës 21.05.2017 deri me 12.06.2017, si dhe me përcaktimin e dimensioneve, dhe shumës së kompensimit 11,700.00 euro. Prandaj, paneli konsideron se parashtruesi i ankesës, me dëshminë e ofruar nuk i ka vërtetuar pretendimet e parashtruara në ankesë, në mënyrë që PZAP-i, të merr vendim në favor të tij

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.168/2017 më datën 10.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.